



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 140
Prishtinë, më 19 shtator 2013, ora 12:00

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19, 26 SHTATOR DHE 2 TETOR 2013**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, Jakup KRASNIQI, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit HALITI.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Teuta Haxhiu, Vesna Mikiq, Aurora Bakalli, Zenun Pajaziti, Time Kadrijaj, Emilija Rexhepi, Alma Lama, Burim Ramadani dhe Xhevdet Neziraj, diskutimet e të cilave janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi - cili është motivi i largimit të z. Slavisha Filipoviq, nga detyra e zv/ministrit të FSK-së? A lidhet ky largim me skandalin e spiunazhit lidhur me dërgimin e informacioneve për armatimin e FSK-së, në një parti politike në Beograd, nga z. Sllavisha Filipoviq?
Kryeministri Hashim Thaçi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Kryetari, në vazhdim të punimeve konstatoi se në sallë janë të pranishëm 37 deputetë dhe Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me pikat e rendit të ditës së seancës së sotme plenare.

Kryetari në mungesë të kuorumit i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 14:55, ndërsa për vazhdimin e saj do të vendosë Kryesia e Kuvendit, në takimin e radhës me kryetarët e grupeve parlamentare.

* * *

E enjte, më 26 shtator 2013

Vazhdim mbledhjes plenare, të filluar më 19 shtator

Kryetari i njoftoi deputetët se dy pikat e para të rendit të ditës kanë përfunduar më 19 shtator 2013.

Në vazhdim lidhur me rendin e ditës për fjalë u paraqitën deputetët Nait Hasani dhe Ali Sadriu.

Nait Hasani, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor propozoi që në rend dite të radhitet edhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.

Kryetari e hodhi në votimi propozimin e deputetit Nait Hasani.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e mjedisit, natyrës, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit të radhitet si pikë e fundit e kësaj seance.

Ali Sadriu, në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, propozoi që shqyrtimi i raportit vjetor të punës të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012, të shtyhet për njëjërën nga seancat plenare të radhës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Ali Sadriu.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që shqyrtimi i raportit vjetor të punës të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012, të shtyhet për njëjërën nga seancat plenare të radhës.

Kuvendi, me shumicë dërmuese miratoi propozimin e deputetit Ali Sadriu.

Në vazhdim Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-102,

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht,
8. Shqyrtimi i Raportit i të Komisionit për Drejta e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi Gjinore,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE

Kryesuesi i seancës, Sabri Hamiti, theksoi se për miratimin i këtij projektligji nevojiten 2/3 e votave të deputetëve, atëherë në mungesë të numrit të nevojshëm të deputetëve do të kalohet në pikën vijuese të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për investimet e huaja.

Ministrja Mimoza Kusari-Lila tha se qëllimi i këtij projektligji do të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Kosovë, duke u ofruar investitorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore që u japin siguri investitorëve të huaj, në mënyrë që investimet e tyre të mbrohen dhe do të trajtohen në mënyrë të drejtë, në pajtim të plotë me sundimin e ligjit, standardet dhe praktikat të pranura ndërkombëtare.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për investimet e huaja.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Zenun Pajaziti, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ramiz Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Hykmete Bajrami, Nijazi Idrizi, Muhamet Mustafa, Albana Fetoshi, Hashim Deshishku, Shaip Muja, Albin Kurti, Ardian Gjini, Ismet Beqiri, Zenun Pajaziti dhe ministrja Mimoza Kusari-Lila, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për investimet e huaja. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 38,
Kundër ----- 30,
Abstenime ----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për investimet e huaja.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagxhilar tha se qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i strukturës organizative, funksioneve dhe përgjegjësi të Institutit të Kosovës për Administratë Publike.

Në vazhdim ai foli për përgjegjësitë dhe funksionet kryesore të Institutit të Kosovës për Administratë Publike si dhe për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Idriz Vehapi, në emër të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Xhevahire Izmaku, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sadri Ferati, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Afrim Kasolli, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Jeton Svirca, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Albert Kinolli, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Sabri Hamiti, Arsim Bajrami, Jakup Krasniqi dhe ministri Mahir Jagxhilar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 38,
Kundër -----18,
Abstenime ----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-102

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-102.

Ministri i Financave, Besim Beqaj, tha se ky projektligj rregullon zgjatjen e mandatit të Bordit të Pavarur për Rishqyrtim si dhe thjeshtësimin e dispozitave ndëshkimore të ligjit bazik.

Në vazhdim ai theksoi se ky projektligj thjeshtëson mbi 40 lloje të dispozitave ndëshkimore, eviton disa gabime gjuhësore në ligjin bazik dhe e harmonizon atë me ndryshimet e fundit legjislative.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-102.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa; Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albana Fetoshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim për këtë pikë të rendit të ditës, andaj kalohet në shqyrtimin e pikës së radhës.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht.

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, tha se qëllimi i këtij projektligji është rregullimi i përdorimit të mbikëqyrjes elektronike në procesin e drejtësisë penale për të ngritur sigurinë publike dhe për të garantuar ekzekutimin efektiv të vendimeve të gjykatës dhe të panelit për lirim me kusht, duke i respektuar të drejtat e personave të përfshirë.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin e tij në parim.

Pastaj kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Armend Zemaj, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Suzan Novobërdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi, më pas konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për të proceduar me votim për këtë pikë të rendit të ditës, andaj kalohet në shqyrtimin e pikës së radhës.

8. Shqyrtimi i raportit i të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore

Deputetja Suzan Novobërdaliu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve të Kuvendit raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore.

Në fund, ajo i paraqiti rekomandimet, që ishin përfshirë në raportin e Komisionit FunkSIONAL dhe ftoi deputetët për miratimin e raportit me rekomandime.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione për mbikëqyrjen zbatimit të Ligjit për barazi gjinore.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Xhevahire Izmaqu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Kymete Bajraktari, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar “ZB”, si dhe Kymete Bytyçi, Blerta Deliu-Kodra, Hydajet Hyseni, Alma Lama dhe zv/kryeministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi, në mungesë të kuorumit për të proceduar me votimin e pikave të rendit të ditës i mbylli punimet e mbledhjes së sotme në orën 17:40 minuta, ndërsa për vazhdimin e saj do të vendosë Kryesia e Kuvendin në takimin e radhës.

* * *

E mërkurë, 2 tetor 2013, ora 11:00

Vazhdim mbledhjes plenare, të filluar më 19 dhe të vazhduar më 26 shtator

Mbledhjen e drejtoi Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit Haliti.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë dhe procedoi me pikat e papërfunduara të rendit të ditës.

Ai procedoi për pikat si në vijim:

- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE.

Ministri i Financave, Besim Beqaj tha se ky projektligj ka për qëllim krijimin e kushteve ligjore për kryerjen e procedurave të anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës.

Në vazhdim, ai u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit, për të cilin tha se përmban vetëm tetë nene.

Në fund, ministri ftoi deputetët për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji e paraqiti dhe arsyetoi deputeti Naser Osmani.

Pastaj, kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Naser Osmani - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Goran Marinkoviq, në emër të Grupit Parlamentar ZB, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku, 80 vota “për” dhe se ky projektligj i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Më pas kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në BZHKE.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 92,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet ligji nr.04/L-222 për ratifikimin e neneve të Marrëveshjes Themeluese të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe anëtarësimin e Kosovës në Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës.

2. Ligji i dërgohet për shpallje presidentes së Republikës së Kosovës.

- Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-102

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në mbledhjen e mbajtur më 26 shtator 2013, mirëpo, në mungesë të kuorumit, votimi është shtyrë.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-102

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 75,
Kundër ----- 9,
Abstenime -----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-102.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin në afatin e paraparë me Rregullore si dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës, ose të Panelit për Lirim me Kusht.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 91,
Kundër ----- 0,
Abstenime -----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si Komision Funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin në afatin e paraparë me Rregullore si dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi i raportit i të Komisionit për Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore

Kryetari e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 89,
Kundër ----- 0,
Abstenime -----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për barazi gjinore.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32.

Në fund, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----87,
Kundër -----0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale